



PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT	
Nr. 13	Prot.
Tiranë, më 14. 8. 2022	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË

U D H Ë Z I M I P Ë R G J I T H S H Ë M

NR. 02 datë 11.08.2022

**P Ë R Z B A T I M I N E U R D H Ë R I T T Ë P Ë R G J I T H S H Ë M T Ë P R O K U R O R I T T Ë
P Ë R G J I T H S H Ë M N R. 56 D T. 29.07.2022 "P Ë R M I R A T I M I N E P L A N I T T Ë
V E P R I M I T P Ë R Z B A T I M I N E R E Z O L U T Ë S S Ë K U V E N D I T D A T Ë
14.07.2022 "P Ë R V L E R Ë S I M I N E V E P R I M T A R I S Ë S Ë P R O K U R O R I S Ë S Ë
P Ë R G J I T H S H M E P Ë R V I T I N 2021"**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është për të lehtësuar zbatimin e urdhërit nr.56 dt 29.07.2022 të Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrë "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021", (depozituar në Prokurorinë e Apelit më datë 04.08.2022) për ndjekjen dhe zbatimin e tyre, bazuar në nenin 4 të Urdhërit lartpërmendur, gjithnjë duke respektuar pavarësinë e brendëshme të prokurorëve për përfaqësimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit,

Neni 2

Objekti

Përcaktimi i masave administrative që duhet të merren për realizimin e përparësive që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022, në kompetencë të Prokurorisë së Apelit Tiranë.

Përcaktimi i masave proceduriale lidhur me përmbushjen e detyrimit të parashikuar në lidhjen 3, pika 5 të vendimit të Kuvendit nr.49/2017 "Për krijimin e mekanizmit për

monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj", në përputhje me objektivat institucionale të prokurorisë, si dhe mënyrën e vlerësimit të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit që çojnë në rritjen e efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022.

Përcaktimi i mënyrës dhe formave të komunikimit mes prokurorëve me drejtuesin e prokurorisë, për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve prioritare për problematikën që rezulton gjatë gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Neni 3

Masat administrative

3.1 Shpërndarja e urdhërit nr.56 dt 29.07.2022 të Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrë "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021", për njohjen dhe vlerësimin nga ana e prokuroreve dhe stafit mbështetës të Prokurorisë së Apelit Tiranë dhe organizimi i mbledhjes për diskutimin dhe dhënien e mendimit të tyre lidhur me masat, aktivitetet dhe mënyra e zbatimit të tij.

3.2 Brenda 10 ditëve nga mbledhja e prokurorëve, (e cila do të zhvillohet në muajin shtator 2022 për shkak se prokurorët e Prokurorisë së Apelit Tiranë, kanë planifikuar lejet e zakonshme dhe nuk janë prezent së bashku gjatë kësaj periudhe) të realizohet përgatitja e planit të veprimit për vlerësimin e masave dhe aktivitetet në afatet e përcaktuara për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022 në Prokurorinë e Apelit Tiranë.

3.3 Njohja me këtë Plan Veprimi Prokuroreve të Apeli dhe stafit mbështetës.

3.4 Informimi në Prokurorinë e Përgjithshme (Sektorin e Monitorimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional), në mënyrë periodike çdo tre muaj, dhe sa here kërkohet, për ecurinë e masave administrative e proceduriale, përpjekjeve dhe progresin e arritur në zbatim të secilit prioritet të rekomanduar, të shoqëruara me tregues statistikore të saktë e analitik dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, arritjet dhe problematikën, dhe si ka ndikuar zbatimi i tyre mbi gjëndjen e kriminalitetit në prioritetet e rekomanduara.

3.5 Analiza në mënyrë të detajuar, në raportin vjetor të punës së prokurorisë, për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022 në prokurorinë e Apelit Tiranë, lidhur me arritjet, problematikën dhe si ka ndikuar zbatimi i tyre mbi gjëndjen e kriminalitetit në drejtimet e rekomanduara.

3.6 Prokurorët të jenë aktive në trajnimet që zhvillohen nga Shkolla e Magjistratures, dhe të tjera të organizuara si nga institucione e organizata kombëtare/ndërkombëtare apo dhe trajnime të përbashkëta me fokus në luftën kundër dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve.

Drejtuesi do të marrë masat e nevojshme për ngarkesën e punës në mënyre që të respektohen datat e zhvillimit të seminareve.

Këtu duhet të jenë në vëmendje të prokurorëve dhe mundësia e përzgjedhjes së programeve trajuese për çështjet prioritare, dhe mbetet rol i drejtuesit të verifikojë dërgimin në kohë pranë Shkollës së Magjistraturës së programit të zgjedhur dhe institucione të tjera të specializuara.

3.7 Prokurorët të jenë aktivë në mbledhjet tematike që zhvillohen periodikisht nga Drejtuesi, duke prezantuar në këto takime problematikat e evidentuara gjatë veprimtarisë së përditshme, veçanërisht ato që lidhen me rekomandimet prioritare

3.8 Sekretaria e Prokurorisë së Apelit Tiranë, të tregojë një kujdes të veçantë në përpilimin e treguesve statistikorë periodik për veprat penale të dhunës në familje dhe ndaj të miturve si dhe identifikimin e viktimave të veprës penale lartpërmendur.

Neni 4

Masat proceduriale

4.1 Mbikqyrja e respektimit të parashikimeve të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.10/2020 dhe Nr.11/2020, mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, mbi informimin, transparencën, dhe garantimin e pavarësisë, dhe të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë" si në lidhje me qëndrimin e prokurorit për masat e sigurimit ashtu dhe me çështjet e themelit, për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies, duke garantuar paanshmerine dhe shmangien e çdo lloji influence apo ndikimi ndaj prokurorit gjatë gjykimeve në drejtimet prioritare të rekomanduara në zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022.

4.2 Prokurorët, në respektim të pavarësisë së tyre të brendëshme, të mbështesin rastet e gjykimeve të drejtëpërdrejta dhe zbatimin e insituteve proceduriale penale, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare të rekomanduara.

4.3 Marrja e masave administrative nga ana e Sekretarisë së Prokurorisë së Apelit përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit, me qëllim evidentimin e rasteve të gjikimit të çështjeve prioritare në regjistrat perkates, duke pasqyruar ecurine e çështjes, dhe

kontrolli në vazhdimësi për saktësinë e të dhënave të regjistruara, administruara. Po kështu edhe bashkëpunim në mënyrë sistematike me kancelarin e Gjykatës së Apelit.

4.4 Të kihet në vëmendje të K/sekretares së Prokurorisë së Apelit, dërgimi në afat në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe jo vetëm, me synim përmirësimin e koordinimit institucional në lidhje me raportimin e të dhënave statistikore, që lidhen me progresin e integritetit të vendit në drejtimet prioritare të rekomanduara në zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022.

4.5 Verifikimi sistematik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve në gjykim për veprat penale prioritare të rekomanduara, sidomos në fushën e mardhënieve juridiksionale me autoritet e huaja, duke monitoruar në veçanti, afatet procedural në Gjykatën e Apelit lidhen kryesisht me afatet e paraburgimit. Në këtë rast koordinimi me kancelarin e gjykatës për t'ju dhënë prioritet gjykimin të këtyre çështjeve.

4.6 Organizimi i takimeve periodike me prokurorite e tjera veçanërisht ato të rrethit gjyqësor që janë në juridiksionin e Prokurorisë së Apelit Tiranë, kur kjo kërkohet ose për veprat penale prioritare të rekomanduara, me qëllim evidentimin e problematikes lidhur me këto çështje që rezultojnë gjatë gjykimin.

4.7 Të tregohet kujdes dhe vëmendje nga prokurorët për zbatimin e rekomandimeve të pasqyruara në Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022, për të kërkuar sipas rastit aplikimin e dënimeve alternative kryesisht në veprat penale dhe autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht tek të miturit, personat vulnerabel dhe ata me probleme shëndetësore si dhe masave të sigurimit alternative.

4.8 Në raport me theksin që vihet tek Rekomandimet për veprat penale dhe autorët me rrezikshmëri të lartë shoqërore, e sidomos në fushën e parandalimit dhe goditjen e veprave penale në fushën e pastrimit të parave, trafikimit të lëndëve narkotike, krimet mjedisore, zhvillimi i paligjshëm i lojrave të fatit, zgjedhjet e lira, prokurorët të mbajnë në vëmendje ashpërsimin e masave të sigurimit dhe dënimeve.

4.9 Rritja e cilësisë së përfaqësimit dhe akteve për procedimet për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale, çështjeve në fushën e krimeve financiare, shpërdorimit të fondeve publike, pastrimit të parave.

4.10 Garantimi i të drejtave të njeriut në procedimet penale, të drejtat për proces të rregullt, të parimit të barazisë së shtetasve para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

Në këtë aspekt, nga ana e prokurorëve duhet të monitorohen dhe evidentohen problematikat në lidhje me shkelje të mundshme të të drejtave të palëve në proces, të cilat pasqyrohen në aktet/ankimet e palëve ndaj vendimeve dhe sjelljeve të prokurorëve.

4.11 Në kuadrin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personit, prokurorët e Apelit Tiranë, duhet të mbajnë në vëmendje afatet e shuarjes së masave të sigurimit për shkak të mbarimit të dënimit, si dhe afatet e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.

4.11 Përgjigje në kohë e letërkërkesave të Eurojust dhe autoriteve gjyqësore të vendeve të tjera.

4.12 Përgjigje në kohë e letërkërkesave të Eurojust dhe autoriteve gjyqësore të vendeve të tjera.

4.13 Evidentimi i problematikave do të bëhet me qellim grupimin e tyre dhe informimin e Prokurorit të Përgjithshëm në raportimin periodik që kërkohet sipas Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.56 dt 29.07.2022 .

Neni 5


Hyrja në fuqi

5.1 Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët dhe të gjithë nënpunësit e tjerë të administratës të Prokurorisë së Apelit Tiranë.

5.2 Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUES I PROKURORISE

Genti XHOLI

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to be 'GX' or similar, written over a large, loopy circular mark.